



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.17.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË
KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONAVE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit Edona Abazi-Demolli, dhe anëtares së ekipit Lindita Ajeti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	21
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	24
Shtojca III: Letërkonfirmimi	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/09/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Agjencisë gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e U.D. e Zëvendës Drejtorit**

U.D. e Zëvendës Drejtorit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave (tash e tutje Agjencia). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063), dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Ushtruesja e Detyrës së Zëvendës Drejtorit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe

është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063).

Ushtruesja e Detyrës së Zëvendës Drejtorit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin dhe raportin përfundimtar të Prokurimit;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë, një sërë fushash kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fushat ku nevojiten këto përmirësime kanë të bëjnë me planifikimin për projektet kapitale, tejkalimi i praktikës së menaxhimit të pozitive me ushtrues detyre përtej afateve të lejuara dhe harmonizimi i plotë i të hyrave (depozitave).

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,609,658	1,795,308	1,698,144	1,853,112	2,004,640
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,609,658	1,795,308	1,697,143	1,711,257	1,713,712
Donacionet e jashtme	-	-	-	140,402	289,499
Depozitat në mirëbesim	-	-	1,001	1,453	1,429

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 814,350€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë² ku investimet kapitale ishin reduktuar për 490,000, mallrat e shërbimet me 290,500€, shërbimet komunale me 9,500€ dhe pagat e mëditjet me 24,350€.

Në vitin 2017, Agjencia ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 1,698,144€, që tregon se realizimi i buxhetit të këtij viti është në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Vendimi i Qeverisë nr.08/151 i datës 02.08.2017, Vendimi 10/19 i datës 15.12.2017 dhe Vendimi 01/21 i datës 22.12.2017

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,609,658	1,795,308	1,698,144	1,853,112	2,004,640
Pagat dhe Mëditjet	1,163,790	1,139,440	1,132,216	1,259,690	1,388,483
Mallrat dhe Shërbimet	854,145	563,645	494,212	505,109	541,713
Shërbimet komunale	98,023	88,523	68,221	69,702	74,444
Investimet Kapitale	493,700	3,700	3,495	18,611	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte realizuar 88%. Megjithatë, nëse krahasojmë buxhetin final me atë fillestar, vërehet një reduktim të mjeteve për 290,500€. Kjo ka ndodhë për arsye se Agjencisë i ishin ndarë fonde shtesë në vlerë prej 300,000€ të cilat ishin të destinuara për kompensimin e palëve të treta për pronat për të cilat janë identifikuar pronarët legjitim.

Meqenëse ndarja e këtyre mjeteve nuk ka qenë në kodin ekonomik përkatës dhe për arsye të mungesës së Komisionit përgjegjës për shqyrtimin e këtyre rasteve, këto mjete nuk janë shpenzuar (shpërndarë);

- Realizim i ulët ishte edhe në kategorinë e shpenzimeve komunale me vetëm 77%. Kjo ka ndodhur për shkak të disa ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në zyrat regjionale, si: zvogëlimi i shpenzimeve të telefonisë, virtualizimi i serverëve, si dhe ndryshimi i nxemjeve nga sistemi i rrymës në atë me naftë; dhe
- Realizimi i buxhetit final për investime kapitale ishte 94%. Megjithatë, ajo për të cilën karakterizohet ky vit në Agjenci te kjo kategori ishte reduktimi pothuajse i plotë i buxhetit për investime kapitale nga Qeveria.

Projekti kapital për pajisje të teknologjisë informative ishte i ndarë në Llote dhe Agjencia kishte nënshkruar kontratën në fund të vitit, mirëpo pasi që projekti nuk ishte përfunduar shpenzimet pritet të ndodhin në vitin 2018.

Çështja 1 - Dobësi në planifikimin e projekteve kapitale

- E gjetura** Për vitin 2017 ishin planifikuar katër projekte kapitale e ku vetëm njëri prej tyre me vlerë prej 3,495€ ishte realizuar. Kjo kishte ndodhur për shkak se projektet kapitale për pajisje të teknologjisë informative sipas planit të prokurimit do duhej të fillonin në muajin prill 2017, por që kjo nuk kishte ndodhur për shkak të vonesave në inicimin e kërkesave nga departamenti përkatës për fillimin e procedurave të blerjes. Qeveria në gusht e kishte reduktuar pothuajse 80% të buxhetit të kapitaleve duke e pamundësuar realizimin e projekteve, në këtë vit.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur dhe mos realizimi i projekteve me kohë rrezikon të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në reduktimin e buxhetit për vitet e ardhshme.
- Rekomandimi 1** U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i shkaqeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të projekteve kapitale, si dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten. Performanca e projekteve kapitale duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara me kohë, në realizimin e projekteve kapitale.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Agjencia në vitin 2017 ishin në vlerë 43,774€. Të hyrat e mbledhura krijohen kryesisht nga taksa administrative prej 10% për administrimin e pronave, përkatësisht në shumën e mbledhur nga pjesa e rentës. Të hyrat e inkasuara transferohen në buxhetin e konsoliduar.

Ne testuam dhe verifikuam se të hyrat janë inkasuar dhe raportuar në pajtueshmëri me ligjet përkatëse, kurse diferencat në mes llogarive bankare dhe SIMFK-së janë trajtuar në vijim:

Çështja 2 - Mos harmonizimet në mes llogarive bankare në BQK dhe SIMFK

E gjetura Vlera e tri llogarive bankare të mirëbesimit, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë, vazhdojnë të kenë diferenca me ato në SIMFK.

Në raport me vitet paraprake, Agjencia kishte arritur ta zbrësë këtë diferencë, megjithatë në fund të vitit 2017 kjo diferenca kishte mbetur në vlerë prej 7,300€. Prej tyre: llogaria e rentës në BQK dallon nga ajo në SIMFK me -1,554€; e depozitave me 7,179€, dhe ajo e inventorit³ me 1,675€.

Rreziku Mos harmonizimi i llogarive bankare me të dhënat në SIMFK rezulton me keqkuptim të pozitës financiare të Agjencisë dhe me informata jo të plota për shfrytëzuesit e raporteve financiare.

Rekomandimi 2 U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të vazhdojë bashkëpunimin e mëtejshëm me Thesarin, kjo për qëllim të eliminimit total të këtyre diferencave për llogaritë në fjalë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave dhe shtesave ishte 1,139,440€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 1,132,216€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

³ Fondi nga pronat pa pronar

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i planifikuar i stafit në Agjenci ishte 242, kurse numri aktual në dhjetor të vitit 2017 sipas PFV-ve ishte 198. Diferenca prej 44 është rezultat i mungesës së anëtarëve të bordit, komisioneve përkatëse dhe mungesës së strukturës së re organizative e cila ka pamundësuar edhe rekrutimin e stafit për të përmbushur misionin e dalë nga ligji i ri.

Çështja 3 – Mbulimi i pozitave udhëheqëse me Ushtrues Detyre

E gjetura Ligji i Shërbimit Civil SHC-03/L149, neni 30 përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet me ushtrues të detyrës (UD) për më shumë se tre muaj.

Në Agjenci kemi identifikuar se gjashtë pozita menaxhuese janë të mbuluara me UD për më gjatë se tre muaj. Prej tyre dy pozita janë nga viti 2014, një nga viti 2015, dy nga viti 2016, dhe një pozitë nga qershori i vitit 2017.

Rreziku Menaxhimi me UD përtej afateve ligjore rritë rrezikun që zyrtarët e emëruar mund të hasin në pengesa në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në raport me kërkesat. Kjo ndikon që përgjegjësia dhe llogaridhënia në punë të mos përfillet dhe e gjithë kjo reflektohet edhe në menaxhimin jo efektiv.

Rekomandimi 3 U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Praktika e menaxhimit me UD duhet tejkaluar pasi që ka ndikim vendimtar për funksionimin kontrolleve dhe arritjen e objektivave.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 952,168€. Prej tyre ishin shpenzuar 562,433€. Ne kemi rishikuar proceset e blerjes së mallrave apo shërbimeve të pranuar, duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit. Nga këto testime, vlerësojmë se Agjencia kishte arritur të zbatojë kërkesat ligjore, qofshin financiare apo ato të prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 101,700€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar vetëm 3,495€. Ato kanë të bëjnë me blerjen e një licence për back-up softwer me procedura të rregullta të prokurimit.

Procedurat e prokurimit ishin menaxhuar në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) të Agjencisë e shpalosur në PVF ishte 85,136€. Kurse, pasuri jokapitale (nën 1,000€) ishin 51,625€, dhe vlera e stoqeve ishte 20,751€.

Ne rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 3,279€. Kjo vlerë përfaqëson tarifën administrative në qira për muajin dhjetor 2017. Këto të arkëtueshme janë realizuar në muajin janar 2018.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 26,967€, prej tyre 23,007€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 3,960€ për shërbime komunale. Të gjitha këto janë fatura të pranuar gjatë muajit dhjetor dhe muajit janar 2018, për shërbimet e pranuar për vitin 2017. Agjencia kishte raportuar në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Agjencisë për vitin 2016, ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i Agjencisë ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, megjithëse ende mbetet sfida zbatimi i plotë i tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, shtatë rekomandime janë zbatuar, dy janë në proces të zbatimit, ndërsa dy nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur dy rekomandime prej të cilave, një është në proces të zbatimit kurse rekomandimi lidhur me ekzekutimin e buxhetit mbetet i pazbatuar edhe këtë vit.

Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën II.

Çështja 4 – Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

- E gjetura** Agjencia kishte bërë progres në zbatimin e rekomandimeve, sipas planit të veprimit 2016, megjithatë mbeten ende disa fusha kyçe ku rekomandimet nuk janë zbatuar. Rekomandimet që po përsëriten nëpër vite kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve kyçe me UD, mos harmonizimi i llogarive të depozitave me llogaritë e Thesarit (ky ka qenë edhe rekomandim në Raportin e vitit 2015), dhe realizimet e ulëta të buxhetit.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
- Rekomandimi 4** U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor me stafin përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i një pjese të madhe të rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Agjencia në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Menaxhmenti informohet në baza javore në formë të përgjithshme lidhur me aktivitetet e zhvilluara, dhe në baza tre mujore me raporte të detajuara.

Agjencia kishte përgatitur me kohë planin për zbatimin e rekomandimeve, si dhe kishte arritur të zbatoj një pjesë të konsiderueshme të rekomandimeve. Po ashtu, ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, për të cilat ishte bërë edhe azhurnimi i kësaj liste në baza tre mujore.

Ndërkaq sfidat me të cilat Agjencia vazhdon të ballafaqohet dhe të cilat kërkojnë përmirësim në fushën e qeverisjes janë: themelimi i shumicës së organeve funksionale të Agjencisë (Bordi Mbikëqyrës, Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore), përgatitja e Planit Strategjik dhe azhurnimi i Strukturës Organizative konform mandatit dhe misionit të saj si dhe themelimi i komitetit të auditimit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit, njëherit Drejtor i NjAB-së. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve.

NjAB kishte hartuar Planin Strategjik 2017-2019 dhe Planin Vjetor të Punës ku janë përfshirë njësitë dhe fushat që paraqesin ndjeshmëri më të lartë, e të cilat ishin planifikuar të auditohen. Për vitin 2017 janë planifikuar dhe realizuar gjashtë auditime. Auditimet kanë mbuluar fushën e administratës, transportit, menaxhimit të pasurive, burimet njerëzore, njësinë e financave dhe njësinë e prokurimit.

Për secilën njësi të audituar është përgatitë plani i veprimit të menaxhmentit ku janë përshkruar veprimet që do të ndërmerren dhe periudha e zbatimit të rekomandimeve. Nga NjAB janë dhënë 19 rekomandime, prej të cilave 16 janë zbatuar dhe tri janë në proces të adresimit.

Çështja 5 – Mos themelimi i Komitetit të Auditimit

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Organizatave Buxhetore bazuar në ligjin për auditimin e brendshëm duhet ta kenë të themeluar komitetin e auditimit (KA). KA përveç që mbështetë menaxhmentin e lartë në përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin efektiv të parasë publike, siguron edhe pavarësinë e NjAB-së, mbikëqyrë planet dhe rezultatet e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve. Agjencia ende nuk e ka të themeluar këtë komitet. |
| Rreziku | Mungesa e KA rritë rrezikun që NjAB të mos jetë mjaft efektive në punën e saj qoftë për shkak të mungesës së pavarësisë apo edhe mos përfilljes së mjaftueshme të punës dhe rekomandimeve të tyre. |
| Rekomandimi 5 | Menaxhmenti i Agjencisë duhet ta themeloj KA-në brenda një periudhe të shkurtër kohore në mënyrë që puna e NjAB-së të monitorohet dhe të jetë efektive përmes zbatimit të rekomandimeve. |

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se Agjencia edhe këtë vit është ballafaquar me një sërë problemesh sa i përket çështjeve që reflektojnë në llogaridhënie dhe përmbushje të misionit dhe misionit të saj.

Çështja 6 – Sfidat në përmbushjen e misionit dhe objektivave të Agjencisë

E gjetura Edhe pse nga nëntori i vitit 2016, kishte hyrë në fuqi Ligji⁴ i ri për transferimin e AKP-së në Agjencia, duke reflektuar kështu edhe në ndryshimin e misionit të saj, ende nuk janë përfunduar disa procedura të rëndësishme për fillimin e funksionimit sipas këtij ligji. Lidhur me mandatin e ri, janë aprovuar disa rregullore të brendshme, megjithatë mbeten edhe shumë çështje të cilat kanë mbetur pezull:

- Mungesa e Bordit Mbikqyrës nga muaji korrik 2017. Edhe pse ky Bord deri këtë kohë ka qenë në mungesë të dy anëtarëve vendor, tre anëtarët tjerë kanë ushtruar funksionin e këtij Bordi. Mirëpo nga dorëheqja e njërit anëtar ndërkombëtar gjatë vitit, Bordi nuk kishte funksionuar në mungesë të kuorumit;
- Mungesa e dy Komisioneve (Komisioni për Verifikim dhe Vendosje të Pronave, dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore) brenda Agjencisë, si organe kryesore në zbatimin të plotë të mandatit të saj. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos emërimeve dhe aprovimeve nga Kuvendi i Kosovës të numrit të plotë të anëtarëve në Komisionet përkatëse (duke përfshirë këtu anëtarët vendor dhe ndërkombëtar);
- Udhëheqja e Organizatës nga Ushtrues Detyre e Zëvendës Drejtorit për një kohë të gjatë (nga vitit 2014). Procesi i përzgjedhjes ka filluar në vitin 2018 dhe është në proces; dhe

⁴ Ligji nr.05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave

- Mungesa e Planit Strategjik dhe e azhurnimit të Strukturës Organizative, konform mandatit dhe misionit të ri.

Vlen të theksohet se lidhur me mungesën e Bordit Mbikqyrës dhe funksionimit të Komisioneve, menaxhmenti i Agjencisë gjatë muajit dhjetor 2017 kishte marrë hapa lidhur me ngritjen e kësaj çështje. Shqetësimin e kishte drejtuar tek organet kompetente, mirëpo deri në kohën sa ne ishim në auditim nuk kemi vërejtur se janë marrë masa për zgjidhjen e tyre.

Rreziku

Mosplotësimi i pozitive kyçe drejtuese dhe mbikëqyrëse brenda Agjencisë, rezulton me reduktim të efektivitetit administrativ dhe arritjes së misionit dhe objektivave të saj. Po ashtu, mungesa e Planit Strategjik dhe e azhurnimit të Strukturës Organizative mund të rezultojë me devijime në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe humbje potenciale financiare.

Rekomandimi 6

U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të vazhdojë bashkëpunimin dhe përpjekjet e mëtejme me Kuvendin dhe Qeverinë për përshpejtimin e procedurave për themelimin e Bordit, Komisioneve dhe Drejtorit Ekzekutiv. Themelimi i këtyre organeve do të sigurote vendimmarrje efektive dhe do të përshpejtonte procesin e aprovimit të strukturës së re organizative dhe plotësimin e vendeve të punës sipas buxhetit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Zëvendës Drejtori Ekzekutiv (ZDE) duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		
2.4 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	ZDE duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi. Lista kontrolluese duhet të rishikohet duke marrë në konsiderim të gjitha kërkesat e parapara më qëllim të arritjes së objektivave në organizatë.	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	ZDE duhet të sigurojë se përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek zyrtarë përkatës dhe të monitoroj funksionalizimin e planit për menaxhimin e rreziqeve.	Po		
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	ZDE duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të realizimit të buxhetit për investime kapitale në 2015 dhe të përcaktojë opsionet praktike për planifikimin e duhur të shërbimeve/furnizimeve në organizatë.			Nuk janë marrë masa.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	ZDE duhet të siguroj që informatat e paraqitura për fondin e depozitave (saldo fillestare dhe përfundimtare) janë të shpalosura drejt në PVF-të të AKP-së, me qëllim të konsistencës në raportim, dhe që diferencat të korrigjohen në afat sa me të shkurtër kohor. Në anën tjetër, për mjetet e mbledhura nga norma administrative të konsideroj barazimin pas çdo mbyllje të periudhës mujore.		Janë bërë disa korrigjime të shumave por ende nuk është siguruar një harmonizim i plotë.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.2 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Plani strategjik duhet të përmbajë azhurnimet e nevojshme në pajtim me ndryshimet e mandatit të ri të Agjencisë. Rishikimi i informatave nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) mbështet menaxhmentin për vërtetësinë e vet-vlerësimit.	Po		
2.3.1 Procesi i tranzicionit	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të vazhdojë të insistojë në plotësimin e pozitave të lartcekura. Kjo mund të përfshijë njoftimin e Qeverisë respektivisht Gjykatës Supreme për nevojën e plotësimit të këtyre pozitave dhe paraqitjen e tyre pranë Kuvendit të Kosovës për miratim. Një hap i tillë duhet të ndërmerret para përfundimit të vitit 2017.		Janë dërguar shkresa për informimin e disa institucioneve. Mbetet ende gjendja e njëjte.	
2.3.2 Raportimi menaxherial	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.	Po		

2.4 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të sigurojë që plani i veprimit për rekomandimet e NjAB-së përcakton afatet kohore, personat përgjegjës dhe veprimet e kërkuara për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Tërë procesi duhet të monitorohet nga menaxhmenti për të arritur synimet e caktuara.	Po		
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet t'i rishikojë arsyet e mosrealizimit të rekrutimeve respektivisht të buxhetit dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të shmangur pengesat e tilla në të ardhmen. Planifikimi i aktiviteteve dhe buxhetit duhet të bazohet në analiza adekuate dhe progresi duhet të monitorohet në mënyrë sistematike.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të Hyrat	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet t'i rishikojë kontrollet për menaxhimin e të hyrave dhe, nëse është e nevojshme, t'i ridizajnojë ato për të siguruar që të hyrat inkasohen, regjistrohen dhe harmonizohen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe rregullat financiare. Mosbarazimet ndërmjet llogarive duhet të adresohen deri më 1 tetor 2017 ndërsa taksat administrative duhet të zbatohen në shumën e përcaktuar (bruto).		Sa i përket harmonizimit të llogarive bankare, janë arritur disa rregullime. Mirëpo, ende mbeten diferenca të cilat duhet të rregullohen.	
3.1.1 Të Hyrat	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të sigurojë që stafi financiar posedon njohuritë dhe/apo trajnimet adekuate në aplikimin e kërkesave të ligjeve tatimore dhe ato të zbatohen në situatat relevante gjatë aktiviteteve të Agjencisë. Tatimi në burim duhet të ndalet dhe të deklarohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës për të gjitha situatat e parapara me legjislacionin në fuqi.	Po		

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet të identifikojë veprime efektive që sigurojnë se procedurat e rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira planifikohen në mënyrë të mirëfillte dhe fillojnë me kohë. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet pozitave të larta e që udhëhiqen me UD me qëllim që të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu duhet të shqyrtohen opsionet e mundshme për kompensimin e zyrtarëve që nuk janë aktiv ne punët e përditshme.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet	U.D. e Zëvendës Drejtorit duhet ta konsideroj një rishikim të Vendimit për shpenzimet telefonike për të siguruar që nivelet e shpenzimeve janë të arsyetuara dhe reflektojnë nevojat reale të Agjencisë dhe shpenzim në mënyrë ekonomike.	Po		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREĐIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE
KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY



Për verifikim të pronës private • Za verifikaciju privatne imovine • For private property verification

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

znj. Florije Kika,

UD e Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave,

Data: 10.Maj.2018, Prishtinë,

